

RREGULLORE KOMUNALE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 5, pika 3, 3.1, 3.5, nenit 6,24,32,35 pika 4, nenit 50 pika 3, nenit 76,92, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025, nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 55 pika “m” e **Statutit të Komunës së Gjakovës** 01Nr. 011-10 datë 26.12.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.03. 2012 miratoi:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Me këtë Rregullore synohet krijimi i bazës juridike për mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal për qytetarët e Komunës së Gjakovës, në mënyrë që të jetë e përballueshme dhe në përputhshmëri me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Komunës, të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit dhe mjedisit.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik për sigurimin e kushteve dhe masave për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit duke përfshirë detyrimin dhe përdorimin me përgjegjësi të resurseve natyrore, me qëllim të realizimit të së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndetshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Ligjit Nr./L për Mbrojtjen e Mjedisit.

Neni 4 Përgjegjësitë e komunës

1. Komuna bënë aplikimin e plotë të parimeve mjedisore të përcaktuara në nenit 4 të kësaj rregullore dhe në nenin 6 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit;
2. Bashkëpunonë me Ministrinë për përgatitjen e Planit Lokal për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe Zhvillim të Qëndrueshëm brenda territorit të saj;
3. Aprovon dhe zbaton planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës;
4. Zbaton dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të saj,

5. Bënë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territoreve të saj;
6. Përgatitë dhe siguronë informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;

Neni 5

Parimet për mbrojtjen e mjedisit

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit;
3. Parimi i vigjilencës dhe parandalimit;
4. Parimi i parandalimit zbatohet përmes Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
5. Parimi “ndotësi paguan”;
6. Parimi “shfrytëzuesi paguan”;
7. Parimi i përgjegjësisë subsidiare;
8. Parimi i masave inkurajuese;
9. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë
10. Parimi i qasjes së publikut në informata.
11. Parimi i nivelit të lartë të mbrojtjes.
12. Parimi i masave paraprake.
13. Parimi e rregullimit të dëmi mjedisor në burim.
14. Parimi i mbulimit të shpenzimeve.

Neni 6

Instrumentet mjedisore

Komuna ka kompetenca për rregullimin e zbatimit të instrumenteve për mbrojtjen e mjedisit në territorin e saj përmes:

1. Infrastrukturës ligjore komunale;
2. Dokumenteve për mbrojtjen e mjedisit;
3. Instrumenteve ekonomike;
4. Dokumenteve për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
5. Instrumenteve për monitorimin e mjedisit;
6. Menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga personat juridik ose fizik.

PLANET, PROGRAMET DHE RAPORTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 7

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis dhe Programet Mjedisore

1. Komuna përmes Drejtorive përkatëse përgatitë Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (ne tekstin e mëtejshëm PLVM), ndërsa Kuvendi Komunal e miraton atë;
2. PLVM duhet të jetë në përputhje Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis;

3. Në hartimin e PLVM duhet të marrin pjesë edhe publiku, OJQ-të, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit.
4. Komuna i raportonë Kuvendit Komunal dhe Ministrisë për zbatimin e PLVM;
5. Në bashkëpunim me komuna tjera, Komuna mund të hartojë dhe miratojë plane ose programe të përbashkëta të veprimit për mbrojtjen e mjedisit për zvogëlimin e efekteve negative në mjedis.

Neni 8

Planet e intervenimit në rast të aksidentit në mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, në territorin e saj, Komuna e nxjerr plane të intervenimit dhe informon Ministrinë.
2. Planet e intervenimit nga paragrafit 1. të këtij neni përmbajnë:
 - 2.1. llojet e rrezikshmërisë;
 - 2.2. procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
 - 2.3. subjektet për zbatimin e masave të caktuara;
 - 2.4. përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.
3. Planet e interevinimit ne rastetet e aksidenteve mjedisore duhet te jene ne harmoni me Planin Lokal dhe Nacional te reagimit ne rastet e emergjencave.

Neni 9

Raporti për gjendjen e mjedisit

1. Drejtorija e Urbanizmit përgatit raportin vjetor për ngjendjen mjedisore në Komunë. Raporti përfshinë, veç tjerash, të dhëna për:
 - a) gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis;
 - b) ndikimet mjedisore në shëndetin publik.
 - c) dëmet mjedisore;
 - d) implementimin e planeve lokale dhe planeve tjera, si dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik;
 - e) marrja e masave për mbrojtjen e natyrës, si dhe efektet nga masat e marra në zhvillimin ekonomik.
 - f) evoluimin e shpenzimeve për aktivitetet mjedisore të bëra nga Drejtorija e Urbanizmit.

PLANIFIKIMI HAPËSINORË

Neni 10

Kompetencat e komunës

1. Komuna ka kompetenca në rregullimi i hapësirës dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore sipas kushteve të përcaktuara me Planin Hapësinorë të Kosovës, Planin Zhvillimorë Komunal, Hartën Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme.
2. Gjatë aktiviteteve për rregullimin e hapësirës dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore komuna duhet të respektojë
 - 2.1. kapacitetin e ndotjes së mjedisit;
 - 2.2. ruajtjes, ripërtitjen dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore në mënyrë racionale;
 - 2.3. sigurimin e mbrojtjes dhe funksionimit të qëndrueshëm të vlerave natyrore të mbrojtura së bashku me rrethinën e tyre;
 - 2.4. sigurimin e mbrojtjes dhe funksionimit të qëndrueshëm të vendndodhjeve dhe vendbanimeve natyrore të llojeve të egra bimore dhe shtazore dhe të bashkësive të tyre;
 - 2.5. sigurimin e mbrojtjes së hapësirës së ndërtuar;
 - 2.6. sigurimin e kushteve për pushim dhe rekreacion;
 - 2.7. përcaktimin e masave për mbrojtjen e mjedisit;
 - 2.8. përcaktimin e masave të nevojshme në kuadër të planeve zhvillimore dhe planeve rregulluese.
3. Komuna përgaditë dhe miraton Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës, dhe Planet Rregulluese të Hollësishme sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin e Planifikimit Hapësinorë;

Neni 11

Plani Zhvillimor Komunal

1. Përmes Planit Zhvillimor Komunal, komuna siguron masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe përcakton:
 - 1.1. kriteret e veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës, burimeve të furnizimit me ujë, burimeve të ujërave termale dhe minerale, pyjeve, tokës bujqësore, sipërfaqeve të gjelbëruara publike, zonave rekreative etj;
 - 1.2. zonat e rrezikuara të mjedisit, zonat e ndotura, zonat e rrezikuara nga erozioni dhe përmytjet, zonat për eksploatimin e resurseve natyrore etj., dhe masat për sanimin e këtyre zonave;
 - 1.3. masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit, sipas të cilave duhet të përdoret hapësira e përcaktuar për eksploatimin e resurseve natyrore, respektivisht, ku do të ndërtohen objektet industriale dhe energjetike, objektet për përpunimin dhe deponimin e mbeturinave, objektet të infrastrukturës dhe objektet tjera, me ndërtimin ose shfrytëzimin e të cilave mund të rrezikohet mjedisi.

2. Kushtet për sigurimin e masave të cekura në paragrafin 1. të këtij neni, komuna i përcakton komuna, më kërkesë të institucionit kompetent për hartimin dhe miratimin e planit, dhe në bazë të mendimit të organizatave profesionale kompetente.

MBROJTJA E NATYRES DHE BIDOVERSITETIT

Neni 12

Kryerja e punëve administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës

1. Komuna kryen punët administrative dhe profesionale në mbrojtjen e natyrës për kategoritë e zonave të mbrotjura të shpallura nga ajo.
2. Komuna në pajtim me ligjin e natyrës, strategjinë e biodiversitetit, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor është e detyruar që të:
 - 2.1. kujdeset për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
 - 2.2. shpallë zonat e mbrojtura për të cilat është kompetente;
 - 2.3. siguronë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat është kompetente;
 - 2.4. marrë pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
 - 2.5. marrë pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat është kompetente;
 - 2.6. kujdeset për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe jepë mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës;
 - 2.7. përcjellë gjendjen e ruajtjes së natyrës në territorin e saj dhe përgatit raporte për gjendjen e natyrës;
 - 2.8. mbanë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
 - 2.9. informonë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë;
 - 2.10. ofronë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë;
 - 2.11. kryenë dhe punë të tjera të përcaktuara me ligjin e natyrës dhe aktet nën ligjore të nxjerra prej tij.

Neni 13

Dokumentet komunale për mbrojtjen e natyrës

1. Komuna detyrohet që të nxjerrin programin për mbrojtjen e natyrës për territorin e vet.
2. Programin për mbrojtjen e natyrës për territorin e komunës nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë në harmoni me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Bidoversitetin.
3. Komuna **përmes drejtorive përkatëse** harton dhe miraton raportin për gjendjen e mbrojtjes së natyrës për territorin e vet.
4. Raporti nga pika 3 e këtij neni duhet të përgaditet në baza dy vjeçare dhe dërgohet për informin edhe në Ministri.

Neni 14

Zonat e mbrojtura të natyrës

1. Pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria, komuna shpallë zonat e mbrojtura të kategorive: Monument i natyrës, peizazh i mbrojtur dhe monument i arkitekturës së parqeve, që shtrihen në territorin e saj.
2. Komuna shpall zonat e mbrojtura në territorin e saj edhe me propozimin e ministrisë në afat prej tre muajsh nga dita e pranimi të propozimit.
3. Komuna organizon dhe udhëheqë procedurën e qasjes publike për shpalljen e zonave të mbrojtura nga paragrafi 1 i këtij neni.
4. Komuna themelon drejtoritë për administrimin me zonat tjera të mbrojtura nga paragrafi i 1 i këtij neni me pëlqim të Ministrisë.
5. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë të punës dhe akteve nënligjore të drejtorive të cilat administrojnë me zonat e mbrojtura të cilat i themelojnë komunat e kryejnë organet kompetente të komunës.
6. Nëse zona e mbrojtur e shpallur nga komuna i humbë vlerat për të cilat është mbrojtur, organi i cili e ka nxjerr aktin për mbrojtje, nxjerr aktin për ndërprerjen e mbrojtjes pas marrjes paraprake të pëlqimit të Ministrisë.

Neni 15

E drejta e kompensimit për kufizimet në shfrytëzimin e zonës së mbrojtur

1. Nëse përdorimi dhe shfrytëzimi i zonës të mbrojtur të shpallur nga komuna për qëllimet e caktuara është kufizuar ose ndaluar, pronari ose përdoruesi i ligjshëm i asaj zone të mbrojtur ka të drejtë në kompensim për kufizimet të cilat i janë bërë.
2. Lartësia e kompensimit përcaktohet me marrëveshje.
3. Në rast të konfliktit vendos gjykata kompetente.
4. Kompensimi paguhet nga buxheti i komunës.

Neni 16

Kufizimet në qarkullimin juridik dhe e drejta e parablerësit

1. Pronari i patundshmërisë i cili ka për qëllim me e shitë patundshmërinë brenda zonës së mbrojtura të shpallur nga komuna, është i detyruar që më par t`ja ofroj komunës, e më pas Qeverisë së Kosovës.
2. Pronari i patundshmërisë brenda zonës së mbrojtur është i detyruar që në ofertë të caktoj çmimin dhe kushtet e shitjes.
3. Komuna është e detyruara që ofertën t`a shqyrtojnë në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e marrjes të ofertës në formë të shkruar.

Neni 17

Ndërhyrja në natyrë

1. Shqyrtimin kryesor i kërkesave për ndërhyrje në natyrë në territorin e komunës zbatohet nga **organi kompetent i komunës.**

2. Nëse me shqyrtimin kryesor vërtetohet se ndërhyrja e planifikuar nuk ka ndikim të dëmshëm në qëllimet e ruajtjes dhe tërësisë së zonës së rrjetit ekologjik, **organi kompetent i komunës** nxjerr vendimin për lejimin e ndërhyrjes.
3. Me vendim përcaktohen masat për zbutjen e pasojave të dëmshme në zonën natyrore.
4. Gjatë shqyrtimit kryesor **organi kompetent i komunës** duhet të kërkoj mendimin paraprak të Institutit për Mbrojtjen e natyrës, ndërsa vendimin nga paragrafi 2. e këtij nenit, t'ia parashtojë Ministrisë.

MBROJTJA DHE MENAXHIMI I RESURSEVE UJORE

Neni 18

Përgjegjësitë e komunës për mbrojtjen dhe menaxhimin e resurseve ujore

1. Lëshimin e lejeve ujore komunale të përcaktuar sipas aktit nënligjor për leje ujore.
2. Jep të drejtën personave të interesuar, për të marrë pjesë si investitor në ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve ujore për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave apo qëllime tjera të cilën e ndërton komuna;
3. Është kompetente për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme brendave zonave urbane të komunës;
4. Në bashkëpunim me Autoritetin Rajonal të Pelgjeve Lumore (ARPL) komuna është kompetente për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastruktures mbrojtëse në shtretërit e lumenjve, përfshirë edhe pritrat malore, muret mbrojtëse dhe objektet tjera mbrojtëse.
5. Financimin për rregullim dhe mirëmbajtjen e infrastruktures mbrojtëse në shtretërit e lumenjve dhe objektet tjera infrastrukturore;
6. Të gjitha aktivitetet dhe masat që ndërrmirren nga Komuna në rregullimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen nga ujërat, përfshirë edhe erozionin, duhet të kryhen në harmoni me Strategjinë shtetërore të ujërave, Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, Planet Zhvillimore Komunale dhe Planet Zhvillimore Urbane.
7. Hartimin e Programin për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave e hartojnë komunat në bashkëpunim me ARPL dhe me organet tjera të administratës shtetërore, kompetente për kryerjen e punëve nga fusha e ujërave.
8. Është kompetente për përcaktimin e zonave erozive brenda zonave urbane të komunës;
9. Komuna në bashkëpunim me ARPL përcaktojnë masat dhe punët për mbrojtjen e zonave erozive dhe rregullimin e rrëkeve në bazë të dokumentacionit teknik dhe në përputhje me planet për menaxhimin e pellgjeve lumore.
10. Financimi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e rrëkeve dhe aktiviteteve për mbrojtje nga erozioni në zonën urbane të komunës;
11. Përcaktimin e masat për mbrojtjen e zonave erozive në zonën urbane të komunës;
12. Rregullimi i rrëkeve në zonat urbane të komunës.
13. Menaxhimin me objektet për rregullimin e rrëkesë në zonat urbane.
14. Të njoftojnë Ministrinë në afat sa më të shkurtër kohor me rastin e rrezikut nga erozioni dhe rrëketë.
15. Në bashkëpunim me Ministrinë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, cakton zonat për larje në territorin e saj.

16. Zbatimin e kërkesave për lëshimin e lejeve ujore të deleguara nga Ministria.
17. Kryerjen e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese sipas autorizimeve nga Ministria.
18. Komuna i nështrohet mbikëqyrjes së ligjshmërisë për zbatimin e dispozitave të parapara me Ligjin e Ujërave.

MENAXHIMI I CILËSISË SË AJRIT

Neni 19

1. Organet kompetente komunale, Drejtoria e Sherbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorin e Inspektionit, në përputhje me aktet dhe dispozitat ligjore në fuqi të nxjerra nga Qeveria e Kosovës dhe Komuna do të përcaktojnë rregullat e veprimit për menaxhimin e cilësisë së ajrit në territorin e Komunës.
2. Komuna në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja do të hartojë Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e ajrit.
3. Komuna në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit Rregulloren Komunale për menaxhimin e cilësisë së ajrit.

MENAXHIMI I ZHURMES DHE VIBRACIONIT

Neni 20

Monitorimi i zhurmës dhe vibracionit

1. Komuna e rregullon monitorimin e zhurmës në territorin e saj përmes rregullores së vecantë;
2. Me rregulloren e vecantë për zhurmën përcaktohen:
 - 2.1. kushtet e shfrytëzuesit të impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë dhe vibracion sipas nivelit të paraparë me ligjin e zhurmës;
 - 2.2. kushtet e vendosjes dhe përdorimit të pajisjet për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit;

MENAXHIMI I MBETURINAVE

Neni 21

Menaxhimi i mbeturinave

1. Organet kompetente komunale, Drejtoria e Sherbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtorin e Inspeksionit dhe Kompanitë për grumbullimin (menaxhimin) e mbeturinave, në përputhje me aktet dhe dispozitat ligjore në fuqi të nxjerra nga Qeveria e Kosovës dhe Komuna do të përcaktojnë rregullat e veprimit për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës.
2. Komuna në pajtim me Ligjin për Mbeturina do të hartojë Planin Komunal për Menaxhim

te Mbeturinave.

3. Komuna ne pajtim me Ligjin per Mbeturina do të hartojë Rregulloren Komunale per menaxhim te mbeturinave.

MBROJTJA E TOKËS

Neni 22 Mbrojtja e tokës

1. Personat juridik dhe fizik të cilët me aktivitetet e tyre në territorin e Komunës, bëjnë hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, grumbullimin e mbeturinave, hirit, ngjyrës ose materialeve tjera, ose shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit, duhet të riformojnë shtresën sipërfaqësore të tokës, rivendosin regjimin e mëparshëm ujqor dhe stabilitetin gjeo-mekanik të tokës gjatë veprimtarisë dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve.
2. Komuna duhet të ndërmarr masat preventive për ruajtjen dhe mbrojtjen e tokës bujqësore me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve tjera e sidomos mbrojtjen e tokës bujqësore në sistemin e ujitjes dhe ndalimin e përdorimit të lymit (Udhëzimi Administrativ për menaxhimin e lymit nga trajtimi I ujërave të ndotura, Neni 7)
3. Çdo dyshim në lidhje me mundësinë e ndotjes së tokës bujqësore, personi fizik apo juridik duhet përrastin të njoftoj te organet kompetente komunale,
4. Përdorimi i drejt i plehërave minerale, organike dhe mjeteve për mbrojtjen e bimëve (sipas udhëzimit të prodhuesit)
5. Nëse shkaktari i ndotjes nuk e bën sanimin e tokës bujqësore, atëher organi kompetent Komunal se bashku me Ministrinë e cakton personin i cili do ta kryej sanimin por me shpenzime te personit qe ka shkaktuar ndotjen.

TË DREJTAT, DETYRIME MASAT DHE KUSHTET PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 23 Të drejtat dhe detyrimet

1. Personat fizik dhe juridik mund të kryejnë aktivitete në shfrytëzimin e resurseve natyrore në territorin e Komunës sipas këtyre kushteve:

- 1.1. të i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), në përputhje me Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Udhezimit administrativ për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale dhe kësaj rregulloreje.
- 1.2. kur burimi natyrorë është prone publike komunale përdorimi dhe shfrytëzimi i këtyre burimeve bëhet me koncesion ose ndonjë të drejtë tjetër në përputhje me Ligjin;
- 1.3. gjatë aktivitetit të shmangë çrregullimet mjedisore që rrjedhin prej tij dhe pas ndërprerjes së veprimtarisë, të rehabilitojnë respektivisht të rikthejnë mjedisin në gjendje të mëparshme, në përputhje me projektin e rehabilitimit.

Neni 24

Pëlqimi për shfrytëzim

1. Personat fizik ose juridik nuk mund të zhvillojnë aktivitetet për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.
2. Pëlqimin në lokacion nga paragrafi 1 të këtij neni, e jep Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kurse Lejet Mjedisore Komunale lëshohen nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
3. Personi fizik dhe juridik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të tyre, të planifikoi dhe të zbatoi masat me të cilat duhet të parandaloi ndotjen e mjedisit sipas Ligjeve në fuqi;
4. Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar dhe kthimin e tij gjendjen e mëparshme.

Neni 25

Leja Mjedisore Komunale

1. Leja mjedisore komunale zbatohet për të gjitha llojet e aktiviteteve dhe projekteve të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis dhe të cilat janë paraparë në shtojcat e Ligjit të VNM-së;
2. Leja Mjedisore Komunale lëshohet nga komuna dhe është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik.
3. Aplikimi për Leje Mjedisore Komunale bëhet gjatë procedurës së marrjes së lejes ndërtimore.
4. **Për veprimtaritë ekzistuese që kanë ndikime në mjedis do të zbatohen dispozitat e udhëzimit administrativ për dhënien e lejes mjedisore komunale.**
5. Aplikimi përmban raportin e shkurtër për ndikimet e aktiviteteve apo projekteve në mjedis në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Neni 26

Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1. Komuna duhet të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të harmonizojnë çështjet mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve komunale, duke siguruar se vlerësimi strategjik mjedisor bëhet për planet dhe programet komunale të cilat kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis.
2. Vlerësimi Strategjik Mjedor duhet të jetë në përputhje me vlerësimet tjera të ndikimit në mjedis, si dhe me planet dhe programet për mbrojtjen e mjedisit dhe kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligjin e **Vlerësimit Strategjik Mjedor**.

Neni 27

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1. Komuna duhet të sigurojë zbatimin e Vlerësimi e ndikimit në Mjedis të projektet që zbatohen në territorin e saj dhe që janë subjekt i Lejes Mjedisore Komunale Mjedisore.
2. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për projektet që zbatohen në territorin e komunës dhe që janë subjekt i Lejes Mjedisore Komunale Mjedisore, është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik pa të cilin nuk mund të fillon zbatimi i projektit dhe kryhet në përputhje me procedurën sipas Ligjit të **Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**.
3. Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, zbatohen sipas Ligjit të **Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Udhëzimin Administrativ për Leje Mjedisore Komunale**.

Neni 28

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

1. Komuna duhet sigurojë pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për:
 - 1.1. vlerësimin strategjik mjedisor;
 - 1.2. vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - 1.3. nxjerrjes së akteve ligjore komunale.
2. Publiku informohet përmes mjeteve të informimit për procedurën e marrjes së vendimeve dhe merr pjesë në dhënien e mendimit, komenteve dhe sugjerimeve institucionit kompetent dhe me kohë informohet për vendimin e marrë sipas dispozitave ligjore përkatëse;

Neni 29

Paralajmërimi i publikut

1. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë njofton publikun për marrjen e masave të veçanta në raste të rrezikut të drejtpërdrejtë ose në raste të tejkalimit të nivelit të vlerave të përcaktuara të ndotjes së mjedisit brenda territorit të saj.
2. Kriteret për për vendosjen e masave të posaçme sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të cilin e nxjerrë komuna.

Neni 30

Detyrimi për njoftim dhe bashkëpunim

1. Çdo person që është i njoftuar për dëmtim të mjedisit ose për aksident mjedisor në territorin e komunës, duhet të njoftojë Inspektoratin komunal për mbrojtjen e mjedisit.
2. Policia dhe zyrtarët publik të autorizuar, të cilët, gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare marrin informatë për aksident mjedisor ose çrregullim tjetër mjedisor në territorin e komunës, duhet të njoftojnë menjëherë Inspektoratin për mbrojtjen e mjedisit të komunës.
3. Komuna njofton ministrinë për dëmtimin e mjedisit në territorin e saj dhe masat e ndërmarra për sanimin e dëmit mjedisor.

Neni 31

Statusi i Mjedisit të Rrezikuar dhe shpallja e gjendjes së rrezikshmërisë

1. Statusin e mjedisit të rrezikuar për territorin e komunës e përcakton komuna pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria.
2. Në rast të aksidentit mjedisor, varësisht nga përmasat, brenda ose jashtë pajisjeve dhe vlerësimit të pasojave të cilat mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejt ose të tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, komuna e shpallë gjendjen e mjedisit të rrezikuar dhe për këtë e njofton publikun për masat e ndërmarra.

Neni 32

Ndërmarrja e masave të sanimit dhe përgjegjësia subsidiare

1. Për parandalimin e përhapjes së mëtutjeshme të ndotjes të shkaktuar nga aksidenti mjedisor, personi juridik ose fizik menjëherë ndërmerr masa të sanimit sipas planeve për mbrojtjen me shpenzime të veta.
2. Në rastet kur përgjegjësia për ndotjen e shkaktuar nga aksidenti mjedisor nuk mund të vërtetohet, në rastet e projekteve që i nënshtrohen lejeve komunale përgjegjësinë për sanim e merr komuna;
3. Komuna ndërmerr masat e sanimit, gjegjësisht rehabilitimit sipas planeve të mbrojtjes me shpenzime të veta.
4. Nëse vërtetohet ndotësi i cili është përgjegjës për aksidentin mjedisor, institucioni i cili i ka bartë shpenzimet për mënjanimin e pasojave të ndotjes së mjedisit ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve, nga ndotësi i identifikuar.

Neni 33

Monitorimi i mjedisit dhe qasje në informata

1. Komuna, në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligjin për mbrojtjen e mjedisit me ligjet e veçanta dhe me programet e monitorimit sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në territorin e tyre;
2. Personat juridik ose fizik të cilët veprojnë në territorin e komunës dhe të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre e ndotin mjedisin, në kuadër të përgjegjësi të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me ligjin e mjedisit, ligjet e veçanta dhe programet e monitorimit.
3. Personat juridik ose fizik të cilët me veprimtarinë ose me aktivitetin e tyre mund të ndotin mjedisin, duhet të sigurojnë mjetet financiare për monitorimin e mjedisit.

4. Monitorimi i mjedisit kryhet sipas kushteve të përcaktuara në programin e monitorimit të mjedisit dhe me aktet ligjore përkatëse të miratuara nga Qeveria.
5. Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit në territorin e komunës, përbëjnë informacion publik dhe duhet të përfshihen në Sistemin Informativ të Mbrojtjes së Mjedisit.
6. Të dhënat e monitorimit të realizuara nga monitorimin vetanak, komunat duhet t'ia dorëzojnë Ministrisë sipas formës së përcaktuar me akt nënligjor.
7. Komunat, është e detyruar që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit në territorin e saj, bazuar në të dhënat e monitorimit vetanak.
8. Publiku dhe cdo palë e interesuar ka të drejtë në çdo kohë të ketë qasje në regjistrat ose evidencat që përmbajnë informata dhe të dhëna për gjendjen e mjedisit.
9. Komuna duhet të ofrojë informacionet për gjendjen e mjedisit nga monitorimi vetanak, paraqitësit të kërkesës brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.
10. Kërkesa për dhënien e informacioneve të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit në territorin e komunës mund të refuzohet nëse publikimi i këtyre informatave mund të ndikon në besueshmërinë e punës së institucioneve lokale dhe nëse është paraparë me ligj;

Neni 34

Financimi i mbrojtjes së mjedisit

1. Komuna në kuadër të drejtave dhe detyrimeve të saj, sigurojnë financimin dhe realizimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit.
2. Kriteret, procedurat dhe rregullat për aplikimin e instrumenteve ekonomike për mbrojtjen e mjedisit, zbatohen sipas akteve nënligjore të përcaktuara nga Qeveria.

Neni 35

Kompensimi për ndotjen e mjedisit

1. Ndotësi është i detyruar që të paguajë kompensimin për ndotjen e mjedisit.
2. Në raste të jashtëzakonshme, komuna e cila e ka statusin e zonës së rrezikuar mjedisore përcakton kompensimin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.
3. Qeveria me vendim e miraton ose refuzon kërkesën e komunës për caktimin e lartësisë për kompensimin nga paragrafi 1 i këtij neni, mënyrën e pagesës, si dhe lehtësimet për çdo person juridik ose fizik që me veprimtarinë ose me aktivitetin e vetë ndotë ose mund të ndotë mjedisin.

Neni 36

Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e kësaj rregullore e bënë Inspektorati mjedisor i Komunës.
2. Punët e inspektorit mund t'i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna.

3. Inspektori i mjedisit i komunës ose personi tjetër i autorizuar është i detyruar të hartoj raport mbi kryerjen e mbikëqyrjes, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet e ndërmarra, gjegjësisht të urdhëruara për zbatimin e rregullores.
4. Një kopje e raportit ia dorëzon personit të i cili është bërë mbikëqyrja inspektuese.
5. Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori me vendim me shkrim mund të urdhëroj personin juridik ose fizik që:
 - 5.1. në afat të caktuar të mënjanoj të metat dhe parregullsitë në veprimtaritë dhe aktivitetet, për shkak të cilave ka ardhur ose mund të vijë deri të ndotja e mjedisit;
 - 5.2. të ndalojë përkohësisht kryerjen e veprimtarisë ose aktivitetit në procesin e prodhimit, shfrytëzimin e stabilimenteve, mjeteve dhe pajisjeve nga të cilat ka ardhur ose mund të vijë deri tek ndotja e konsiderueshme e mjedisit;
 - 5.3. të ndalojë kryerjen e aktivitetit në procesin e prodhimit, përdorimin e stabilimenteve, mjeteve dhe pajisjeve nga të cilat ka ardhur ose mund të vijë deri të një ndotje më e madhe e mjedisit, derisa të metat dhe parregullsitë në punë të mos eliminohen;
 - 5.4. të ndalojë punimet nëse ato kryhen në kundërshtim me masat e përcaktuara për vlerësimin e ndikimit në mjedis deri sa parregullsitë të mënjanohen;
 - 5.5. të ndërpres punimet nëse ato nuk kryhen në pajtueshmëri me kushtet e dhëna;
 - 5.6. të ndaloj punët për të cilat ai nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë profesionale për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 37 **Procedura e ankesës**

1. Në procedurën e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, në rastet e marrjes së masave për urdhëresa dhe ndalesa, Inspektori i Mjedisit **apo zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna** nxjerr vendim;
2. Për rastet e eliminimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për mjedisin, jetën dhe shëndetin e njeriut ankesa e ushtruar kundër vendimit të Inspektorit **apo zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon komuna**, nuk e shtynë ekzekutimin.
3. Në ankesën kundër vendimit të organit kompetent komunal vendos Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
4. Afati i paraqitjes së ankesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 38

Personat fizik dhe juridik dënohen për shkelje mjedisore në pajtim me masat ndëshkuese si në vijim:

1. masat ndeshkuese mandatare (me vlerë prej 5-100 €, në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ për gjobat mandatare, 04/2009.
2. masat ndeshkuese kundërvajtëse (Ligji për kundërvajtjet kundër rendit dhe qetësisë publike, dënimet me gjobë prej tridhjetë (30) deri pesëqind(500) Euro.
3. masat ndëshkuese penale (bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës).

Neni 39

Ndëshkimet me gjoba

Me gjobë prej 100-500 € dënohet personi fizik, dhe 1000 deri në 3000 € personi juridik për shkelje mjedisore, nëse:

1. a) Shfrytëzon burimet natyrore pa leje për shfrytëzim (neni 6 dhe 7);
- b) fillon realizimin e projektit pa hartimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pa pëlqimin e organit kompetent (neni 17);
- c) Nuk ndërmer masa sanimi dhe rehabilitimi dhe nuk pajiset me pelqim dhe leje mjedisore nga Komuna (neni 11);
- d) Kryen veprimtari në zona të mbrojtura, sipërfaqet publike të gjelbëruara në të cilat rrezikohet mjedisi, ekuilibri natyror, vlerat natyrore e kulturore (shih Nenet 7.3, dhe 8.3);
- e) Hedh mbeturinat dhe materiet e rrezikshme në mjedis jashtë lokacioneve të destinuara për këtë (neni 13 dhe 14).

2. Me gjobë prej 100-500 € dënohet personi fizik, dhe 1000 deri në 3000 € personi juridik nëse:

- a) Vepron në kundërshtim me Ligjet në fuqi, si dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje;
- b) Pengon inspektorin komunal të mjedisit në kryerjen e obligimeve nga neni 31.2 i kësaj Rregullore;
- c) Inspektorët komunal të mjedisit në pajtim me kompetencat e tyre shqiptojnë gjobat mandatore.

3. Mos informimi i Komunës, respektivisht Drejtorive të Urbanizmit dhe Inspektionit, nga ana e operatorit i cili me aktivitetin e tij mund të sjellë kërcënim të drejtpërdrejtë për mjedis dhe aksident mjedisor, sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje dhe mosmarrja e masave të nevojshme për të parandaluar dëmin në mjedis, pavarësisht nga detyrimi i tij për marrjen e masave parandaluese, dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000-3,000 €.

4. Mosinformimi i Komunës nga operatori se me gjithë masat e marra, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, pavarësisht nga detyrimi i tij për të siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas përcaktimit të nenit 18 të kësaj Rregulloreje dënohet me gjobë në vlerën nga 5,000-10,000 €;

5. Kushdo që duke e shkelur ligjin bën ndotjen ose degradimin e mjedisit apo shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore dhe me këtë shkakton rrezik për mjedisin dhe jetën a shëndetin e një numri të madh të njerëzve dënohet me burgim deri në dy vjet (Neni 276 i Kodit Penal të Kosovës).

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Për aplikimin e kësaj Rregulloreje janë përgjegjëse Komuna përmes drejtorive përkatëse.

Neni 41

Me miratimin e kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja nr.xxx për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 42

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, miratimit nga MAPL dhe Shpalljes në veb faqen e Komunës.